

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Hashim Çollaku, kryetari i kolegjit, Shqipe Qerimi e Ferit Osmani, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.M. nga Gjilani, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur sipas ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.871/2015 të datës 11.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 02.02.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.871/2015 të datës 11.10.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.871/2015 të datës 11.10.2016, të akuzuarin S.M. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPRK-së, për të cilën gjykata i ka shqiptuar dënim me gjobë në shume prej 200 (dyqind)€ ,të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga data kur aktgjykimi bëhet i formës se prerë. Nëse i akuzuari refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e te pandehurit mund te zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimin me gjobë në punë në dobi te përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet, me dënim me burgim në atë mënyre qe për çdo 20 euro të dënimin me gjobë, do ti caktohet nga një dite burgim. Është obliguar që te paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm. Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, aktgjykimin e atakuar me ankesë ta ndryshojë dhe të akuzuarit ti shqiptoj një dënim më të lartë dhe atë dënim me burg efektiv.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.1586/2016 datë 16.12.2016, ka propozuar që ankesa e prokurorit të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe ndaj te akuzuarit te shqiptohet nje dënim me burgim .

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës

zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 11.10.2016 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, me ankesë prokurori pretendon se Gjykata e shkallës së parë nuk i ka shqiptuar dënim të merituar sipas ligjit, sepse këtë dënim e ka zbutë deri në atë masë e cila bie në kundërshtim me rregullat e përgjithshme për matjen, zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe kufijtë e përcaktuara me nenet 74, 75 e 76 të KPRK. Sipas ankesës, rrethanat lehtësuese çfarëdo qofshin ato, në rastin konkret nuk kanë guxuar të vlerësohen se janë të asaj rëndësie që të ndikonin që dënimin e parashikuar ligjor për këtë veprë penale, ta zbusë në këtë nivel, ku të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me gjobë minimale me mundësi të zëvendësimit me punë në dobi të përgjithshme duke i vlerësuar si rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykatore, pendimin e tij, faktin se i akuzuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale si dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike, kërkim falja të dëmtuarit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e Prokurorit për shqiptimin e një dënimi me burg efektiv ,nuk janë të bazuara .Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 të KPRK-së, me ç'rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë, sjelljen korrekte në gjykatore, pendimin e tij, faktin se i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale si dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike, kërkim falja të dëmtuarit, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale ndërsa, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore.

Kjo gjykatë, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë del se dënimin i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, në fakt në ankesë nuk ceket asnjë rrethanë e re, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, pastaj vlen të theksohet se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar rrethanat lehtësuese të theksuara në ankesën e Prokurorit, ku një vlerësim të tillë si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë. Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore, në rastin konkret gabimisht i ka vlerësuar si rrethana rënduese edhe pse ato paraqesin elemente të veprës së kryer.

Pra, duke marrë parasysh mënyrën dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dhe rrethanat tjera, si faktin se i akuzuari dhe i dëmtuari janë miq 25 vite si dhe

faktin se i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale si dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike, kjo gjykatë vlerëson se dënimi të cilin të akuzuarit ia ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1554/16 me datë 02.02.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit-gjyqtari

1. Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi

3. Ferit Osmani